



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:110313

Datë: 09.07.2024

Numri i dokumentit: 05915288

KF.nr.530/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Global Trade AF” me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Albana Kelmendi, avokate në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti 3,946.27 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 20.06.2024 në mungesë të përfaqësueses së autorizuar të paditësit, dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Mehdi Krasniqi, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Global Trade AF” me seli në Fushë Kosovë.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/2382 i datës 06.05.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit N.T.P “Global Trade AF” me seli në Fushë Kosovë, t’ia kthej shumën prej 3,946.27 € (tremijë/e/nëntëqind/e/dyzet/e/gjashtë/euro/e/njëzet/e/shtatë/centë), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-23375/23.07.2019, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren, me kamatë ligjore 8%, nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi 20.06.2024 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësi “Global Trade AF” me seli në Fushë Kosovë, përmes përfaqësueses së autorizuar të tij, me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/2382 të datës 06.05.2021 të të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me q’rast ka kërkuar të Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi kontestues dhe të obligohet e paditura Dogana e Kosovës që këtu paditësit t’ia kthej shumën prej 3,946.27 euro më shumë të arkëtuara me kamatë vjetore 8% nga data 23.07.2019 e deri në kthimin e plotë. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesja e autorizuar e paditësit nuk ka prezantuar ndonëse ftesën për këtë seancë e ka pranuar, ndërsa më parashtrësën e datës 19.06.2024, ka arsyetuar mungesën. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e kundërshton në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se ky vendim është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme relevante juridike. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit deklaroi se: mbesim në tërësi pranë aktvendimit kontestues, konsiderojmë se ky aktvendim është marrë konform KDA-as , andaj pretendimet e paditësit se ekzistojnë shkelje ligjore nuk mund të vërtetohen me asnjë provë të vetme. Në procedurë Dogana ka marrë për bazë të gjitha vërejtjet e gjykatës dhe ka shqyrtuar të gjitha shkresat në lende dhe ka konstatuar se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara duke refuzuar padinë pasi që deklarimi i vlerës së mallit është tejet i ulët , andaj edhe procedimi i lendes sipas nenit 35 të KDA-se është tërësisht i drejtë dhe i ligjshëm. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 20.06.2024, ka administruar provat dhe atë: aktvendimi 01.3.2.2/2382 i datës 06.05.2021, kërkesa për rishqyrtim e ushtruar në Doganë e datës 21.08.2019, fatura nr KS20181206, pagesa bankare ndërkombëtare e datës 18.12.2018, flete ngarkesa e mallit, aktvendimi 01.3.2.2/11026 e datës 19.09.2019, dosja e vlerës, DUD nr. 23375/23.07.2019, procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, përgjigja në padi.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se : subjekti “Global Trade AF” me seli në Fushë Kosovë, këtu paditësi përmes DUD-it nr. R-23375/23.07.2019, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. E paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit nga neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme. Nuk është kontestues as fakti se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal me Aktgjykimet A.nr.2382/2019 të datës 10.03.2021, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, e ka anuluar aktvendimin kontestues, dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim - rivendosje tek e paditura, me ç’ rast prapë ka refuzuar kërkesën e këtu paditësit me vendimin tani kontestues, e ndaj të cilit vendim këtu paditësi ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-it nr. R-23375/23.07.2019, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 3,946.27 €, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të tillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturave të mallit, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes Urdhërpaguesës bankare

ndërkombëtare të datës 18.12.2018 me status të aprovuar për faturën nr. KS20181206, për DUD-in kontestues R-23375/23.07.2019, e cila Urdhërpagesë në kuptim të përshkrimit të pagesës dhe vlerës është e harmonizuar me faturën si më lartë të DUD-it kontestues.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga Dosja e vlerës, në bazë të të cilit vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që, dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit është: *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të cituara, Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturën nr. KS20181206, për DUD-in kontestues R-23375/23.07.2019, të paguar me Urdhërpagesën bankare ndërkombëtare të datës 18.12.2018. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, komfor nenit 33 par.1 të

Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, miratoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloj vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 3,946.27€, të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-23375/23.07.2019, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren, me kamatë ligjore 8%, nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi 23.11.2023, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore, si pasoj e rivlerësimit të mallit nga e paditura nuk u kontestua nga e paditura.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Për kamatën Gjykata ka vendos duke u mbështetur në dispozitat e KDAK-së, Kodi Nr. 03/L-109, neni 292, pika b), *“Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: ((b) Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”*, në rastin konkret e njëjta është e aplikueshme ngase këtu paditësi e ka parashtruar si kërkesë dhe në nenet 378 dhe 382 të LMD-së, ndërsa si moment të fillimit të kamatës mori datën e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, në mungesë të dëshmisë se pagesës së detyrimeve doganore të rivlerësuara.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.530/22 datë 20.06.2024

Zyrtare Ligjore  
Amire JAHIRI

Gjyqtari,  
Fisnik NULI

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.